



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0330

PSH. nr. 0330/26

0331/26

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Kimete Gashi Brajshori Kryetar, Batisha Ibrahim Anetar dhe Vedat Poterqoi Anetar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE “International Security AAH” SH.P.K. dhe ankesës se parashtruar nga Operatori Ekonomik OE “Farilo” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “81 Mirembajtja e ndertesave te IEA – Pastrimi dhe mirembajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve – Lot II”, me numër të prokurimit: 616-26-1322-2-1-1, te iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Komuna e Prishtines, me datën 17.07.2026, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa Operatorit Ekonomik “International Security AAH” SH.P.K. e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 19.05.2026 me numër protokoli 0330/26, si dhe Aprovohet, si pjesërisht e bazuar dhe ankesa e Operatorit Ekonomik “Farilo” SH.P.K. e parashtruar ne Organin Shqyrtues te Prokurimit me 20.05.2026 me numër protokoli 0331/26 për aktivitetin e prokurimit me titull: “81 Mirembajtja e ndertesave te IEA – Pastrimi dhe mirembajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve – Lot II” me nr. të prokurimit 616-26-1322-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Prishtines.

2. Mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit te pershkruar sipas pikes 1. te ketij dispozitivit

3. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës se operatoreve ekonomik si dhe obligohen operatorët ekonomik ankues “International Security AAH” SH.P.K. dhe “Farilo” SH.P.K. që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesën për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 17.03.2026, Komuna e Prishtines në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “81 Mirembajtja e ndertesave te IEA – Pastrimi dhe mirembajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve – Lot II” me numër të prokurimit: 616-26-1322-2-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës Sherbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 3,984,000.00 €.

AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka rekomanduar për dhënie të kontratës: Lot1 GOE “Erik” SH.P.K.&”Schafberger Jr” GmbH kurse për LotII GOE ”Aroma Plus” SH.P.K. & “Krasniqi” SH.P.K.

Me 12.05.2026, OE “International Security AAH” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me date 12.05.2026 po ashtu edhe OE “Farilo” SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues.

Me 14.05.2026, Autoriteti Kontraktues ka publikuar një vendim përmes të cilit hedhen poshtë si te pa bazuara ankesat e te dy Operatorëve Ekonomik dhe vërtetohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me 19/05/2026, OE “International Security AAH” SH.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0330/26. Ndërsa me datë 20/05/2026 OE “Farilo” SH.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën me nr. 0331/26.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, OSHP ka konstatuar se të dy ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesave në mënyrë meritore.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 0330/26 dhe ankesa nr. 0331/26 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “International Security AAH” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Në afatin e lejuar ligjor, në mbështetje të Nenit 109 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Nenit 4.1.26 të LPP-së, Operatori Ekonomik: International Security AAH sh.p.k., në cilësinë e palës së interesit, paraqet këtë Ankesë lidhur me procedurën e prokurimit: Titulli: “81 Mirëmbajtja e ndërtesave të IEA - Pastrimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore dhe kopshteve - Lot II” Nr. prokurimit: 616-26-1322-2-1-1 Nr. i brendshëm: 616-26-9-2-1-1.

1. Autoriteti Kontraktues gjatë fazës së kërkesës për rishqyrtim nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit, edhe përkundër se një gjë të tillë e obligojnë dispozitat ligjore të Nenit 61.1. të Rregullores Nr.001/2022 dhe par.2 i Nenit 108/A të LPP-së. 2. Autoriteti Kontraktues nuk iu është përgjigjur pretendimeve tona ankimore, ajo përmes një vendimi refuzon si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim, duke mos u arsyetuar fare për asnjë pretendim tonin ankimor, edhe pse e ka obligative. 3. Autoriteti Kontraktues ka vepruar me standarde të dyfishta për shkak se për të njejtën procedurë Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë i ka kërkuar sqarime në bazë të Nenit 72 të LPP-së me datën 06.05.2026, kjo vërehet përmes komunikimeve të tyre gjatë vlerësimit të ofertave, kurse kompanisë sonë nuk i ka kërkuar as edhe një kërkesë të vetme për sqarim apo plotësim të ndonjë dokumenti.

I. LIDHUR ME ARSYEN E ELIMINIMIT PËR MENAXHERIN E RISKUT DHE PAGËS 600 EURO Pretendimi i Autoritetit Kontraktues për eliminim se OE nuk ka paraqitur dëshmi për pagën mujore prej 600 euro bruto për menaxherin e riskut sipas standardeve ISO dhe se kjo nuk është përfshirë në analizën financiare është plotësisht i pabazuar, i pasaktë dhe në kundërshtim me Dosjen e Tenderit dhe LPP-në. Në Dosjen e Tenderit, tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, si dëshmi është kërkuar qartë vetëm: - diploma e shkollës së mesme, - certifikata ISO 31000 (për Lot II). Asnjë kërkesë në Dosjen e Tenderit nuk kërkon që paga e menaxherit të riskut të përfshihet në analizën financiare. Kompania jonë ka vepruar "strictus secundum" dosjen e tenderit, duke përfshirë në analizë vetëm ato elemente për të cilat është dhënë kërkesa eksplicite. Nëse Autoriteti Kontraktues do të kishte kërkuar shprehimisht përfshirjen e pagës së menaxherit të riskut në analizën financiare, ne si OE do ta kishim përfshirë pa asnjë hezitim, ashtu siç ishte kërkuar përfshirja e pagës së menaxherit në vlerën prej 700 euro bruto, e për të cilin ne si ofertues e kemi përfshirë në analizën financiare sipas kërkesës së AK-së në dosjen e tenderit. Prandaj, pretendimi i AK është: - i krijuar pas dorëzimit të ofertave, - i pabazuar në Dosjen e Tenderit, dhe - qartësisht diskriminues dhe tendencioz ndaj OE-së tonë. Kjo përbën shkelje të drejtpërdrejtë të Nenit 40.2 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, i cili përcakton se: “Autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.” Rrjedhimisht, ky kriter i aplikuar "ex post" është i paligjshëm dhe i pavlefshëm juridikisht.

II. LIDHUR ME ANALIZËN FINANCIARE (PUSHIMI VJETOR) Pretendimi se analiza financiare është e pasaktë për shkak të llogaritjes së pushimit vjetor me 20 ditë dhe 160 orë në vend të 22 ditëve dhe 176 orëve është plotësisht i pabazuar në ligj dhe në Dosjen e Tenderit. Në kërkesën e AK është kërkuar vetëm përfshirja e pushimit vjetor në analizë, pa asnjë specifikim për metodologjinë e llogaritjes së orëve. 7/12 Sipas Ligjit të Punës Nr. 03/L-212: Neni 32 paragrafi 1: “I punësuari gjatë çdo viti kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor të paguar në një kohëzgjatje prej së paku katër (4) javë, pavarësisht a punon me orar të plotë apo të shkurtuar.” Neni 20, paragrafi 2: “Orari i plotë i punës zgjat dyzet (40) orë në javë, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.” Nga këto dispozita rrjedh qartë se: $40 \text{ orë/javë} \div 5 \text{ ditë në javë} = 8 \text{ orë/ditë}$ $4 \text{ javë pushim} = 20 \text{ ditë pune}$ $20 \text{ ditë} \times 8 \text{ orë} = 160 \text{ orë pushim vjetor}$ Pra, kalkulimi i OE është: - ligjor, - matematikisht i saktë, - i bazuar në normën minimale ligjore. Pretendimi i AK për 22 ditë / 176 orë: - nuk mbështetet në asnjë dispozitë ligjore, - nuk është kërkuar në Dosjen e Tenderit, - përbën kriter shtesë pas dorëzimit të ofertave. Kjo është në kundërshtim me Nenin

40.13 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik, i cili përcakton: “Komisioni vlerësues do ti vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.”

III. LIDHUR ME PËRSHKRIMIN E ÇMIMIT (FORMATI EXCEL DHE NËNSHKRIMI/VULA) Pretendimi se përshkrimi i çmimit nuk është i nënshkruar, i vulosur dhe nuk përmban çmimin përfundimtar është juridikisht i pabazuar dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me rregullat e LPP-së dhe e-prokurimit. Sipas Nenit 17.9 të Rregullores për Prokurimin Publik: “Gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të tenderëve, OE nuk kërkohet të nënshkruajnë manualisht formularin e tenderit (i cili gjenerohet nga sistemi) dhe listën e çmimeve, pavarësisht se a është përdorë Lista e çmimeve standarde ose jo-standarde.”

Po ashtu, Neni 17.8 të Rregullores 001/2022 përcakton qartë: “Për të gjitha procedurat e përgatitura përmes platformës elektronike, AK duhet të përdorin vetëm Listën e çmimeve standarde e cila krijohet nga sistemi ose jo-standarde në formatin excel e cila krijohet nga vetë përdoruesi. Në sistem të prokurimit elektronik dosja e tenderit dhe lista e çmimeve publikohen si dokumente të ndara.” Oferta jonë përfshin të gjitha çmimet përfshirë edhe atë përfundimtar në listën e çmimeve në dokumentin e AK-së në formatin excel. Rrjedhimisht: - dorëzimi në Excel është plotësisht i ligjshëm, - nuk kërkohet nënshkrim manual i dokumenteve të lartëcekura, - pretendimi për pavlefshmëri është kontradiktor me vetë rregulloren. Për më tepër, është shqetësues fakti se: - OE të rekomanduar për kontratë iu është pranuar me dokumente në format PDF duke krijuar rrezik për manipulim të çmimeve me decimalë shtesë, gjë që cenon parimin e transparencës dhe trajtimit të barabartë sipas qëllimit, konkretisht nenit 1 dhe 6 të LPP-së.

IV. LIDHUR ME MUNGESËN E FOTOGRAFIVE TË PAJISJEVE (ANEKSI 7)

Pretendimi për mungesë të fotografive të mjeteve është i pabazuar në Dosjen e Tenderit. Kërkesa e AK ka qenë qartë: - listë pajisjesh, - DUD (deklarata unike doganore), - kontrata / fatura blerjeje, - libreza automjetesh, - marrëveshje shfrytëzimi (kur aplikohet).

OE ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara në mënyrë të plotë dhe të verifikueshme, duke bashkangjitur të gjitha dëshmitë e kërkuara. Asnjë pjesë e Dosjes së Tenderit nuk ka kërkuar obligativisht fotografi të pajisjeve si kriter eliminues.

Për më tepër, sipas Nenit 38.3 dhe 38.4 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik:

“Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve.”

9/12 "Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shtesë në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomik dhe do të kërkojë informacion nga Operatorët Ekonomik me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, çertifikatave të përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje. Sqarimi dhe kërkesa për informacion shtesë, informacion plotësues dhe dokumente është pjesë e procedurës së vlerësimit. Kërkesa kalon / nuk kalon dhe vlefshmëria e ofertave/aplikacioneve mund të vendoset vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve në pyetjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shtesë të paraqitura.”

Gjithashtu, sipas Nenit 40.12 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik:

“Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.” Pra, në vend të eliminimit, AK ka qenë i obliguar të kërkojë sqarim nëse ka pasur paqartësi, kjo bazuar në Nenin 53 dhe Nenin 72 të LPP-së. Fotografitë e pajisjeve nuk mund të jenë bazë për eliminimin e ofertës e cila ka qenë më e lira në mesin e tenderuesve, gjë që për buxhetin e shtetit i bie favorit kursimi i fondeve publike.

V. PAPËRGJEGJËSHMËRIA E OE TË REKOMANDUAR

Kompania jonë menjëherë pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK-së (B58) nga Autoriteti Kontraktues, ka paraqitur kërkesë për qasje në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit, si përmes platformës elektronike të e-Prokurimit, ashtu edhe përmes postës elektronike zyrtare (e-mail) me datën 07.05.2026, në përputhje me të drejtat e garantuara nga Ligji për Prokurimin Publik. Pavarësisht faktit se Autoriteti Kontraktues ka qenë plotësisht në dijeni për kërkesat tona, i njëjti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim administrativ për të mundësuar qasjen në dokumentet e kërkuara deri në ditën e fundit të skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesave për rishqyrtim, duke vepruar në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimet themelore të transparencës, trajtimit të barabartë dhe llogaridhënies, të përcaktuara me nenin 7 dhe nenin 10 të Ligjit për Prokurimin Publik, ku qasja duhet të jetë e shpejtë dhe e arsyeshme. Mosveprimi i Autoritetit Kontraktues dhe heshtja administrative në këtë fazë të procedurës krijojnë dyshime të bazuara lidhur me cenimin e integritetit dhe transparencës së procesit të prokurimit, veçanërisht duke pasur parasysh refuzimin faktik për t'u mundësuar operatorëve ekonomik shqyrtimin e dokumentacionit të ofertës së operatorit të rekomanduar për kontratë. Në këto rrethana, kompania jonë ka dyshime serioze dhe të arsyeshme se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë për Lot-2 mund të mos i përmbushë kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, ndërsa mungesa e qasjes së plotë në dokumentacion pamundëson verifikimin efektiv të ligjshmërisë së vendimmarrjes së Autoritetit Kontraktues. Operatori i rekomanduar për kontratë dyshojmë se nuk plotëson këto kërkesa:

- Kapaciteti teknik dhe ose profesional -

* I njëjti pretendojmë se nuk e ka menaxherin me dokumentacion të plotë, mungojnë dëshmitë përkatëse si: diploma e fakultetit (ekonomik apo juridik), trusti pensional që dëshmon përvojën e punës, kontratën e punës apo parakontratën për angazhim me pagë prej 700 euro bruto.

* I njëjti pretendojmë se nuk posedon MSDS të materialeve përkatësisht etiketat e produkteve konform kërkesës së AK.

* I njëjti pretendojmë se nuk e ka menaxherin e riskut me dokumentacion të plotë, mungojnë dëshmitë përkatëse, znj. Gentiana Krasniqi certifikatën e ISO 31000 nuk është konform standardeve dhe është e lëshuar me datën 29.01.2026 që do të thotë se nuk i ka 3 vite pas certifikimit.

* I njëjti pretendojmë se nuk e ka në rregull Analizën financiare duke munguar elementet përkatëse të ligjit të punës, kërkesë e përmendur nga AK në Dosjen e tenderit.

* I njëjti pretendojmë se certifikatat e punëtorëve për siguri dhe shëndet në punë i ka të skaduara, pasi që të njëjtat certifikata sipas par.5 të Nenit 11 të Ligjit Nr. 04/L-161 Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë kanë vlefshmëri dy (2) vite, andaj certifikatat e vendosura në ofertë përmbajnë datën 09.10.2019 që i bie të jenë të vlefshme deri më 09.10.2021.

* I njëjti pretendojmë se pajisjet e listuara në Aneksin 7 të dosjes së tenderit, nuk ka bashkangjitur dokumentacionin e plotë të pajisjeve, duke munguar dëshmitë ku tregojnë specifikimet e qarta të këtyre pajisjeve; shembull: Krani për pastrimin e xhamave, i njëjti ka bashkangjitur një marrëveshje për shfrytëzim të pajisjes të lidhur me një kompani të huaj, ku nuk mund të konstatohet se pajisja e bashkangjitur është me lartësi 25m siç është kërkuar, poashtu librezja e automjetit supozojmë se figuron e skaduar, nuk ka regjistrim, poashtu sipas marrëveshjes ky kran/automjet në Republikën e Kosovës do ti bëhet Trajtimi i automjeteve me targa të huaja në Kosovë rregullohet nga legjislacioni në fuqi (Neni 41 i Ligjit Nr. 05/L-132 për Automjete, dhe Neni 31 i Ligjit lidhur me Nenin 38 për të Huajt), me rregulla të përditësuara që kanë hyrë në fuqi nga marsi 2026 ku Kohëzgjatja e qëndrimit: Automjetet me targa të huaja lejohen të qarkullojnë në Kosovë maksimumi tre muaj nga data e hyrjes kurse kohëzgjatja e kësaj kontrate është 28 muaj, andaj ligjërisht nuk ka mundësi që ky automjet të përdoret sa edhe

zgjat kontrata; poashtu supozojmë se pajisjet e listuara me numër rendor 8,9,10,11,13,14 poashtu nuk janë sipas kërkesave të AK-së pasi që mungon dokumentacioni i plotë ku mund të shihen specifikat dhe karakteristikat e pajisjeve që janë konform kërkesave të AK-së

* I njejtë pretendojmë se specifikat e pajisjeve sipas numrave rendor të lartëcekur nuk kanë të dhënat specifike si: 50kw, 48v, 750kg, 700-900kg, 40kw, 9kw, 10m, në dëshmitë e dorëzuara.

Gjithashtu, sipas Nenit 7.6.3 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik:

“Zyrtari i Prokurimit sipas kërkesës për qasje në dokumente nga OE (siç përkufizohet në nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1.26 të LPP-së), pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK (B58), ofron qasjen e menjëhershme në versionin e pastruar dhe mban procesverbal, i cili nënshkruhet nga të dyja palët.”

Me çrast Autoriteti Kontraktues, qasjen është dashur ta lejoj ashtu siç thuhet në dispozitën e lartëcekur, menjëherë, e jo të mos e lejoj për palët e interesit.

Në mungesë të qasjes së plotë në dokumentet publike, ne nuk kemi arritur të analizojmë dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, andaj ky veprim i AK-së është i qëllimshëm dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë dëmton kompaninë tonë dhe në anën tjetër favorizon operatorin ekonomik fitues sipas AK-së.

VI. KONKLuzion

Nga sa më sipër rezulton qartë se: - të gjitha arsyet e eliminimit janë formale, të paqëndrueshme dhe të pabazuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, - janë aplikuar kërkesa të reja pas dorëzimit të ofertave, në kundërshtim me LPP dhe Rregulloren 001/2022 për Prokurimin Publik me qëllim të eliminimit të kompanisë sonë, - është shkelur parimi i barazisë, transparencës, trajtimit jo të barabartë (neni 7 i LPP-së) dhe mos-përdorimit ekonomik të fondeve publike (neni 1 dhe 6 i LPP-së). Poashtu vlen të ceket dispozita ligjore e Nenit 40.15 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik: "40.15 Gjatë kohës së vlerësimit të tenderit, informacione në lidhje me shqyrtimin, sqarimin, vlerësimin, krahasimin e tenderëve, pikat e dhënë, dhe rekomandimi për dhënien, nuk do tju zbulohet ofertuesve apo ndonjë personi tjetër që nuk janë të përfshirë zyrtarisht në ekzaminimin, vlerësimin e tenderëve deri sa të jete publikuar Formulari B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK."

VII. KËRKESË

Kërkojmë që Paneli Shqyrtues i OSHP-së: 1. Të aprovojë këtë Ankesë si të bazuar në ligj; 2. Të anulojë vendimin mbi njoftimin e AK-së; 3. Të kthej procedurën në Rivlerësim; 4. Të sigurojë zbatim të drejtë dhe të njëtrajtshëm të LPP-së dhe rregullores për prokurim publik. 5. Të vlerësoj ofertat konform Nenit 59.4 të LPP-së, në vend të eliminimit të qëllimshëm për favorizim të operatorit të caktuar.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Farilo” SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Në afatin e lejuar ligjor, në mbështetje të Nenit 109 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe Nenit 4.1.26 të LPP-së, Operatori Ekonomik: FARILO SH.P.K si lider i grupit pjesëmarrës, në cilësinë e palës së interesit, paraqet këtë Ankesë lidhur me procedurën e prokurimit:

1. Autoriteti Kontraktues gjatë fazës së kërkesës për rishqyrtim nuk e ka pezulluar aktivitetin e prokurimit, edhe përkundër se një gjë të tillë e obligojnë dispozitat ligjore të Nenit 61.1. të Rregullores Nr.001/2022 dhe par.2 i Nenit 108/A të LPP-së
2. Autoriteti Kontraktues nuk iu është përgjigjur pretendimeve tona ankimore, ajo përmes një vendimi refuzon si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim, duke mos u arsyetuar fare për asnjë pretendim tonin ankimor, edhe pse e ka obligative.
3. Autoriteti Kontraktues ka vepruar me standarde të dyfishta për shkak se për të njejtën procedurë Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë i ka kërkuar sqarime në bazë të

Nenit 72 të LPP-së me datën 06.05.2026, kjo vërehet përmes komunikimeve të tyre gjatë vlerësimit të ofertave, kurse kompanisë sonë nuk i ka kërkuar as edhe një kërkesë të vetme për sqarim apo plotësim të ndonjë dokumenti.

1. LIDHUR ME ARSYEN E ELIMINIMIT PËR EMËRTIMIN E GRUPIT

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me pretendimin se “në procesverbalin e hapjes së tenderit emërtimi i grupit të operatorëve nuk përputhet me Deklaratën për themelimin e grupit” është i pabazuar ligjërisht dhe nuk përbën në asnjë rrethanë bazë valide për eliminim të Operatorit Ekonomik.

Operatori ynë ekonomik ka aplikuar në cilësinë e Grupit të Operatorëve Ekonomik konform Nenit 71 të LPP-së, si dhe Nenit 26 të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, duke i përmbushur të gjitha obligimet dhe kërkesat ligjore që ndërlidhen me pjesëmarrjen në procedurë si grup i operatorëve ekonomik

As në Ligjin për Prokurimin Publik dhe as në Rregulloren Nr.001/2022 nuk ekziston ndonjë dispozitë e veçantë që përcakton detyrimin absolut që emërtimi i grupit në procesverbalin e hapjes duhet të jetë identik në formë, strukturë apo shkronjë për shkronjë me emërtimin e paraqitur në Deklaratën për themelimin e grupit. Përkundrazi, dispozitat ligjore kërkojnë identifikimin e qartë të pjesëtarëve të grupit dhe marrëdhënieve të tyre juridike, gjë që në rastin konkret është realizuar plotësisht.

Për shkak të pjesëmarrjes së gjashtë (6) operatorëve ekonomik në kuadër të grupit, emërtimi i përdorur gjatë procesit të aplikimit dhe në procesverbalin e hapjes është paraqitur përmes inicialeve të para të secilit operator ekonomik sipas renditjes së përcaktuar në Deklaratën për themelimin e grupit. Një mënyrë e tillë e paraqitjes është praktikë e pranueshme administrative dhe nuk ndalohej nga asnjë dispozitë ligjore apo nënligjore në fuqi.

Për më tepër, vetë sistemi elektronik i prokurimit (e-Prokurimi) lejon që grupi i operatorëve ekonomik të regjistrohet dhe të paraqitet edhe me emërtim të zgjedhur sipas dëshirës së grupit, përderisa identiteti i pjesëtarëve të grupit dhe dokumentacioni ligjor i tyre është i qartë dhe i verifikueshëm brenda formularit të tenderit. Kjo dëshmon qartë se mënyra e emërtimit të grupit nuk përbën element substancial të ofertës dhe nuk paraqet pengesë ligjore apo procedurale për pjesëmarrje në aktivitetin e prokurimit

Në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me ndryshim të subjektit juridik, ndryshim të përbërjes së grupit apo mungesë identifikimi të operatorëve ekonomik, por vetëm me një formë të shkurtuar të emërtimit të grupit, e cila nuk ndikon në asnjë element substancial të ofertës dhe nuk cenon parimet e transparencës, trajtimit të barabartë apo konkurrencës

Rrjedhimisht, përdorimi i kësaj arsyeje si bazë për eliminim përbën interpretim arbitrar dhe tejkalim të dispozitave ligjore nga ana e Autoritetit Kontraktues, pasi që eliminimi i Operatorit Ekonomik nuk mund të mbështetet në çështje thjesht formale të cilat nuk kanë ndikim material në vlefshmërinë, përmbajtjen apo ligjshmërinë e ofertës.

Andaj, konsiderojmë se ky eliminim është bërë pa bazë ligjore, në kundërshtim me parimet themelore të LPP-së për proporcionalitet, trajtim të barabartë dhe konkurrencë efektive, dhe si i tillë duhet të anulohet.

Kompania jonë ka vepruar "strictus secundum" dosjen e tenderit, duke përfshirë në analizë vetëm ato elemente për të cilat është dhënë kërkesa eksplicite.

Kjo përbën shkelje të drejtpërdrejtë të Nenit 40.2 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, i cili përcakton se:

“Autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.” Rrjedhimisht, ky kriter i aplikuar "ex post" është i paligjshëm dhe i pavlefshëm juridikisht

2. LIDHUR ME ANALIZËN FINANCIARE (PUSHIMI VJETOR)

Pretendimi se analiza financiare është e pasaktë për shkak të llogaritjes së pushimit vjetor me 20 ditë dhe 160 orë në vend të 22 ditëve dhe 176 orëve është plotësisht i pabazuar në ligj dhe në Dosjen e Tenderit.

Në kërkesën e AK është kërkuar vetëm përfshirja e pushimit vjetor në analizë, pa asnjë specifikim për metodologjinë e llogaritjes së orëve.

Sipas Ligjit të Punës Nr. 03/L-212:

Neni 32 paragrafi 1:

“I punësuari gjatë çdo viti kalendarik ka të drejtë për pushim vjetor të paguar në një kohëzgjatje prej së paku katër (4) javë, pavarësisht a punon me orar të plotë apo të shkurtuar.”

Neni 20, paragrafi 2:

“Orari i plotë i punës zgjat dyzet (40) orë në javë, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.”

Nga këto dispozita rrjedh qartë se:

$40 \text{ orë/javë} \div 5 \text{ ditë në javë} = 8 \text{ orë/ditë}$ 4 javë pushim = 20 ditë pune 20 ditë $\times 8 \text{ orë} = 160 \text{ orë}$ pushim vjetor

Pra, kalkulimi i OE është: - ligjor, - matematikisht i saktë, - i bazuar në normën minimale ligjore.

Pretendimi i AK për 22 ditë / 176 orë: - nuk mbështetet në asnjë dispozitë ligjore, - nuk është kërkuar në Dosjen e Tenderit, - përbën kriter shtesë pas dorëzimit të ofertave

Kjo është në kundërshtim me Nenin 40.13 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik, i cili përcakton:

“Komisioni vlerësues do ti vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.”

3. LIDHUR ME PËRSHKRIMIN E ÇMIMIT (FORMATI EXCEL DHE NËNSHKRIMI/VULA)

Pretendimi se përshkrimi i çmimit nuk është i nënshkruar, i vulosur dhe nuk përmban çmimin përfundimtar është juridikisht i pabazuar dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me rregullat e LPP-së dhe e-prokurimit.

Sipas Nenit 17.9 të Rregullores për Prokurimin Publik:

Gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të tenderëve, OE nuk kërkohet të nënshkruajnë manualisht formularin e tenderit (i cili gjenerohet nga sistemi) dhe listën e çmimeve, pavarësisht se a është përdorë Lista e çmimeve standarde ose jo-standarde.”

Po ashtu, Neni 17.8 të Rregullores 001/2022 përcakton qartë:

“Për të gjitha procedurat e përgatitura përmes platformës elektronike, AK duhet të përdorin vetëm Listën e çmimeve standarde e cila krijohet nga sistemi ose jo-standarde në formatin excel e cila krijohet nga vetë përdoruesi. Në sistem të prokurimit elektronik dosja e tenderit dhe lista e çmimeve publikohen si dokumente të ndara.”

Oferta jonë përfshin të gjitha çmimet përfshirë edhe atë përfundimtar në listën e çmimeve në dokumentin e AK-së në formatin excel.

Rrjedhimisht: - dorëzimi në Excel është plotësisht i ligjshëm, - nuk kërkohet nënshkrim manual i dokumenteve të lartëcekura, - pretendimi për pavlefshmëri është kontradiktor me vetë rregulloren.

Për më tepër, është shqetësues fakti se: - OE të rekomanduar për kontratë iu është pranuar me dokumente në format PDF duke krijuar rrezik për manipulim të çmimeve me decimalë shtesë, gjë që cenon parimin e transparencës dhe trajtimit të barabartë sipas qëllimit, konkretisht nenit 1 dhe 6 të LPP-së.

4. LIDHUR ME MUNGESËN E FOTOGRAFIVE TË PAJISJEVE (ANEKSI 7)

Pretendimi për mungesë të fotografive të mjeteve është i pabazuar në Dosjen e Tenderit. Kërkesa e AK ka qenë qartë: - listë pajisjesh, - DUD (deklarata unike doganore), - kontrata / fatura blerjeje, - libreza automjetesh, - marrëveshje shfrytëzimi (kur aplikohet). OE ka dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara në mënyrë të plotë dhe të verifikueshme, duke bashkangjitur të gjitha dëshmitë e kërkuara. Asnjë pjesë e Dosjes së Tenderit nuk ka kërkuar obligativisht fotografi të pajisjeve si kriter eliminues

Për më tepër, sipas Nenit 38.3 dhe 38.4 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik:

“Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues gjatë vlerësimit të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve.”

"Autoriteti kontraktues do të sigurojë mundësinë e sigurimit të informacionit shtese në kushte të njëjta për të gjithë Operatorët ekonomik dhe do të kërkojë informacion nga Operatorët Ekonomik me qëllim të qartësimit të përmbajtjes së deklaratave të paqarta, çertifikatave të përfshira në tenderë apo kërkesave për pjesëmarrje. Sqarimi dhe kërkesa për informacion shtesë, informacion plotësues dhe dokumente është pjesë e procedurës së vlerësimit. Kërkesa kalon / nuk kalon dhe vlefshmëria e ofertave/aplikacioneve mund të vendoset vetëm pas dorëzimit të përgjigjeve në pyetjet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktues dhe pas shqyrtimit të dokumenteve shtesë të paraqitura."

Gjithashtu, sipas Nenit 40.12 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik:

“Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.” Pra, në vend të eliminimit, AK ka qenë i obliguar të kërkojë sqarim nëse ka pasur paqartësi, kjo bazuar në Nenin 53 dhe Nenin 72 të LPP-së. Fotografitë e pajisjeve nuk mund të jenë bazë për eliminimin e ofertës e cila ka qenë më e lira në mesin e tenderuesve, gjë që për buxhetin e shtetit i bie favorit kursimi i fondeve publike.

Këtu Autoriteti Kontraktues ka përdorur standarde të dyfishta, pasi që operatorit të rekomanduar për kontratë për Lot-1, me datën 05.05.2026 përmes letrës standarde për sqarimin e ofertës i ka kërkuar plotësim dokumentacioni.

Shtojcë: Letra standarde e dërguar me datën 05.05.2026.

5. LIDHUR ME ARSYEN E ELIMINIMIT NJË PERSON ME BACHELOR DHE PAGËS 600 EURO

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues se kinse Grupi i Operatorëve Ekonomik “nuk ka paraqitur një person të diplomuar me bachelor dhe të certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare për menaxhimin e riskut me përvojë pune minimum 3 vite pas certifikimit” është plotësisht i pabazuar dhe në kundërshtim me dokumentacionin e dorëzuar në ofertën tonë

GOE ka paraqitur të gjitha dëshmitë e kërkuara në Dosjen e Tenderit lidhur me pozitën e Menaxherit të Projektit, të cilat janë ngarkuar në mënyrë të rregullt në sistemin e e Prokurimit dhe janë lehtësisht të verifikueshme nga Autoriteti Kontraktues.

Dokumentet përkatëse janë të evidentuara në ofertë si në vijim: • “12. Menaxheri i projektit - Elron.pdf” • “12.1. Menaxheri - Elron.pdf” • “12.2. Menaxheri - Internacional.pdf”

Në këto dokumente janë përfshirë dhe dëshmuar në mënyrë të plotë të gjitha kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues, përfshirë por pa u kufizuar në: • CV-të profesionale të personave të propozuar; • diplomat universitare të nivelit Bachelor; • certifikatat përkatëse sipas standardeve ndërkombëtare për menaxhimin e riskut; • para-kontratat dhe dëshmitë mbi pagat konform kërkesave të Dosjes së Tenderit; • dëshmitë nga Trusti Pensional; • si dhe dëshmitë që vërtetojnë përvojën e punës dhe përvojën pas certifikimit.

Rrjedhimisht, pretendimi i Autoritetit Kontraktues se nuk janë dorëzuar dëshmitë e kërkuara nuk qëndron fare, pasi dokumentacioni ekziston në ofertë dhe është dorëzuar në mënyrë të rregullt. Një arsyetim i tillë tregon se ose dokumentacioni nuk është shqyrtuar fare në mënyrë profesionale dhe të kujdesshme, ose është interpretuar në mënyrë të njëanshme dhe jo objektive. Për më tepër, Autoriteti Kontraktues nuk ka specifikuar në mënyrë konkrete se cila nga dëshmitë e kërkuara mungon, cili dokument nuk është valid apo në çfarë mënyre nuk është përmbushur kriteri, por është mjaftuar vetëm me një konstatim të përgjithshëm dhe të paarsyetuar, gjë që bie ndesh me parimet e transparencës dhe arsytimit të vendimeve administrative në procedurat e prokurimit publik. Andaj, konsiderojmë se eliminimi ynë mbi këtë bazë është i kundërligjshëm, i pabazuar në fakte dhe në kundërshtim me dokumentacionin e dorëzuar në ofertë, për shkak se GOE ka përmbushur plotësisht kërkesën e Autoritetit Kontraktues lidhur me Menaxherin e Projektit dhe dokumentacionin mbështetës të kërkuar.

Kompania jonë ka vepruar "strictus secundum" dosjen e tenderit, duke përfshirë në analizë vetëm ato elemente për të cilat është dhënë kërkesa eksplicite. Nëse Autoriteti Kontraktues do të kishte kërkuar shprehimisht përfshirjen e pagës së menaxherit të riskut në analizën financiare, ne si OE do ta kishim përfshirë pa asnjë hezitim, ashtu siç ishte kërkuar përfshirja e pagës së menaxherit në vlerën prej 700 euro bruto, e për të cilin ne si ofertues e kemi përfshirë në analizën financiare sipas kërkesës së AK-së në dosjen e tenderit.

Prandaj, pretendimi i AK është: - i krijuar pas dorëzimit të ofertave, - i pabazuar në Dosjen e Tenderit, dhe - qartësisht diskriminues dhe tendencioz ndaj OE-së tonë.

Kjo përbën shkelje të drejtpërdrejtë të Nenit 40.2 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, i cili përcakton se: "Autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve." Rrjedhimisht, ky kriter i aplikuar "ex post" është i paligjshëm dhe i pavlefshëm juridikisht

6. ELIMINIMI PËR MOS-PËRFSHIRJE TË PAGAVE TË MENAXHERËVE, KËRKESË E RE PAS HAPJES SË OFERTAVE

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues se kinse "nuk janë paraqitur pagat e dy menaxherëve të kërkuar sipas dosjes së tenderit dhe se këto paga nuk janë llogaritur në analizën financiare" është i pabazuar, në kundërshtim me kërkesat reale të Dosjes së Tenderit dhe paraqet interpretim të zgjeruar e arbitrar të kritereve pas përfundimit të afatit për ofertim. Kompania jonë ka vepruar në mënyrë strikte konform Dosjes së Tenderit ("strictus secundum"), duke përfshirë në analizën financiare vetëm ato elemente për të cilat Autoriteti Kontraktues ka dhënë kërkesë të qartë dhe eksplicite.

Kërkesa e përcaktuar në Dosjen e Tenderit ka qenë si në vijim:

"OE duhet me dorëzim të ofertës ta paraqes analizën financiare me pagën bruto 425.00 euro për punëtor sipas ATK-së dhe pushimet vjetore sipas Ligjit të Punës, stazhin e punës dhe materialin higjienik. Kjo kërkesë vlen për dy lotet (1 dhe 2)."

Po ashtu është kërkuar:

"Të paraqes analizën financiare me pagë bruto prej 425.00 euro për punëtor sipas ATK-së, pushimet vjetore, stazhin e punës dhe materialin higjienik."

Nga përmbajtja e kësaj kërkesë rezulton qartë se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar përfshirjen në analizë financiare të: • pagës bruto prej 425.00 euro për punëtor, • pushimeve vjetore, • stazhit të punës, • dhe materialit higjienik.

Askund në Dosjen e Tenderit nuk është specifikuar apo kërkuar shprehimisht që në analizën financiare të përfshihen edhe pagat e dy menaxherëve të projektit për Lot-1, vetëm një kërkesë ka qenë për përfshirje të pagës dhe atë për Lot-2. Rrjedhimisht, Autoriteti Kontraktues nuk mund të krijojë detyrime të reja pas hapjes së ofertave dhe të eliminojë Operatorin Ekonomik

mbi baza që nuk kanë qenë të përcaktuara paraprakisht në Dosjen e Tenderit. Përkundrazi, aty ku Autoriteti Kontraktues ka pasur kërkesë specifike për pagën e menaxherit, ne si Operator Ekonomik do të kishim vepruar plotësisht sipas kërkesës dhe e kishim përfshirë atë në analizën financiare, respektivisht pagën bruto prej 700 euro, ashtu siç ka qenë e kërkuar nga vetë AK-ja në Dosjen e Tenderit. Ne lidhur me pagat e cekura, kemi vendosur parakontratën dhe kontratat me vlerat e njëjta siç e keni përcaktuar në dosjen e tenderit. Kjo dëshmon qartë se OE ka zbatuar në mënyrë të saktë dhe të plotë çdo kërkesë të shprehur nga Autoriteti Kontraktues dhe nuk mund të penalizohet për mos-përfshirje të elementeve që nuk janë kërkuar fare në dokumentacionin e tenderit. Për më tepër, interpretimi i tanishëm i AK-së cenon drejtpërdrejt parimet themelore të prokurimit publik, përfshirë:

- parimin e transparencës,
- trajtimit të barabartë,
- proporcionalitetit,
- dhe sigurisë juridike për operatorët ekonomik.

Operatorët ekonomik nuk mund të eliminohen mbi bazën e kërkesave të nënkuptuara apo interpretimeve subjektive të AK-së, por vetëm mbi bazën e kriterëve të qarta, të shkruara dhe të publikuara paraprakisht në Dosjen e Tenderit. Andaj, konsiderojmë se kjo arsye për eliminim është tërësisht e paqëndrueshme juridikisht dhe faktikisht, pasi GOE ka përmbushur saktësisht kërkesat e Dosjes së Tenderit ashtu siç kanë qenë të formuluar nga vetë Autoriteti Kontraktues .Gjithashtu, sipas Nenit 40.12 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik:

“Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.” 13/24 Pra, në vend të eliminimit, AK ka qenë i obliguar të kërkojë sqarim nëse ka pasur paqartësi, kjo bazuar në Nenin 53 dhe Nenin 72 të LPP-së.

7. LIDHUR ME ELEMENIMIN PËR MUNGESËN E LISTËS SË KONTRATAVE

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues se kinse “Grupi i Operatorëve Ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë vlerën e kontratave të kërkuara” është i pabazuar faktikisht dhe juridikisht, si dhe bie ndesh me dokumentacionin e dorëzuar në ofertën tonë dhe praktikën relevante të OSHP-së. GOE ka vepruar në përputhje të plotë me kërkesat e Dosjes së Tenderit, duke dorëzuar për të gjithë pjesëtarët e grupit listat e kontratave dhe referencat përkatëse që dëshmojnë përvojën e kërkuar profesionale dhe teknike. Pretendimi i AK-së se Operatori Ekonomik Elron Sh.p.k. “nuk e ka plotësuar listën e kontratave të realizuara” nuk është i vërtetë dhe kundërshtohet drejtpërdrejt nga dokumentacioni i ofertës, pasi në ofertën tonë gjendet dokumenti:

- “6.2. Lista e kontratave - Elron.pdf”

Në këtë dokument janë paraqitur lista e kontratave dhe referencat përkatëse sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit. Rrjedhimisht, konstatimi i AK-së se “kjo listë mungon” është faktikisht i pasaktë dhe tregon se dokumentacioni ose nuk është shqyrtuar fare, ose është vlerësuar në mënyrë jo objektive. Për më tepër, sipas paragrafit 4, nën-paragrafit 4.2 të Nenit 69 të LPP-së, specifikohet “listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të shërbimeve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e shërbimeve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin...”; Autoriteti Kontraktues ka obligim që gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të sigurojë trajtim të drejtë dhe proporcional, duke mos eliminuar Operatorët Ekonomik për çështje formale që nuk ndikojnë në substancën e ofertës. Po ashtu, ekziston praktikë konkrete dhe e konsoliduar e OSHP-së lidhur me këtë çështje, respektivisht Vendimi Nr. 589/22 i datës 23.01.2023, ku në një rast identik është konstatuar se për Grupin e Operatorëve Ekonomik mjafton paraqitja e listës së kontratave në mënyrë që të dëshmohet përvoja e kërkuar dhe se mungesa eventuale formale nuk mund të përdoret automatikisht si bazë për eliminim, sidomos kur dokumentacioni tjetër dëshmon

ekziston në ofertë.

Shtojcë: Vendimi i OSHP-së Nr. 589/22 i datës 23.01.2023.

Madje, njëri nga pjesëtarët e grupit tonë ka qenë vetë palë në atë rast, ku OSHP ka refuzuar ankesën pikërisht mbi bazën se lista e kontratave dhe dëshmitë e paraqitura konsiderohen të mjaftueshme për vlerësim.

Gjithashtu, lidhur me pretendimin ndaj OE “Skyfterat Live Sh.p.k.” se referencat “datonin më shumë se tre vite nga njoftimi për kontratë”, theksojmë se AK nuk ka sqaruar konkretisht:

- cilat referenca i konsideron jashtë afatit; • cilat kontrata nuk i plotësojnë kriteret; • dhe mbi çfarë baze është bërë kjo llogaritje.

Një arsyetim i tillë i përgjithshëm dhe pa identifikim konkret të dokumenteve nuk përmbush standardin minimal të arsytimit administrativ dhe nuk mund të prodhojë pasoja juridike për eliminimin e Operatorit Ekonomik. Për më tepër, sipas Udhëzuesit Nr. 002/2024 për Plotësim-Ndryshimin e Udhëzuesit Nr.001/2023 për Prokurimin Publik, konkretisht Nenit 10, në rastet kur mungon lista e kontratave apo ekziston ndonjë paqartësi dokumentare, Autoriteti Kontraktues ka mundësi dhe obligim të kërkojë plotësim/sqarim të dokumentacionit konform Nenit 72 të LPP-së, e jo të procedojë menjëherë me eliminim.

Në rastin konkret, AK nuk ka përdorur fare mekanizmat ligjorë për sqarim apo plotësim të dokumentacionit, ndonëse dokumentet ekzistojnë në ofertë dhe janë lehtësisht të verifikueshme.

Rrjedhimisht, konsiderojmë se ky eliminim është: • në kundërshtim me dokumentacionin faktik të ofertës; • në kundërshtim me praktikën dhe vendimmarrjet e OSHP-së; • në kundërshtim me Udhëzuesin Nr.002/2024; • si dhe në kundërshtim me parimet themelore të proporcionalitetit, transparencës dhe trajtimit të barabartë në prokurimin publik.

Andaj, kërkojmë që kjo arsye për eliminim të shpallet e pabazuar dhe oferta jonë të rivlerësohet në mënyrë të drejtë dhe objektive.

8. LIDHUR ME ELEMENINIMIN PËR MENAXHERIN E PROJEKTIT – INXHINIERIT TË MJEDISIT

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues se kinse GOE “ka paraqitur një menaxher i cili është i certifikuar vetëm për mbrojtjen nga zjarri, ndërsa i mungon certifikata e lëshuar nga AME për vlerësimin e rreziqeve, si dhe për zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera” është i pabazuar faktikisht dhe juridikisht, si dhe bie ndesh me dokumentacionin e dorëzuar në ofertën tonë. GOE ka përmbushur në tërësi kërkesën e Dosjes së Tenderit lidhur me Menaxherin e Projektit – Inxhinierin e Mjedisit, duke bashkangjitur të gjitha dokumentet dhe dëshmitë e kërkuara nga vetë Autoriteti Kontraktues.

Kërkesa e AK-së ka qenë si në vijim: “OE duhet të ketë një menaxher të projektit me vendim i cili duhet të jetë Inxhinier i Mjedisit, i certifikuar si Ekspert i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë nga MPMS/MFPT, gjithashtu i certifikuar për vlerësimin e rreziqeve nga AME, si dhe për zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, me pagë prej 700.00 €.”

Po ashtu, si dëshmi janë kërkuar: • vendimi për caktimin e menaxherit të projektit; • diploma; • CV e nënshkruar nga vetë inxhinieri; • certifikatat nga MPMS; • certifikata nga AME.

GOE ka dorëzuar: • vendimin për emërimin e menaxherit të projektit; • diplomën përkatëse; • CV-në e nënshkruar; • certifikatat nga MPMS/MFPT; • si dhe certifikatën nga AME, konform kërkesave të Dosjes së Tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimi i AK-së se mungon certifikata nga AME nuk qëndron dhe kundërshtohet drejtpërdrejt nga dokumentacioni i ngarkuar në ofertë. Një arsyetim i tillë i përgjithshëm dhe pa analizë konkrete nuk mund të shërbejë si bazë valide për eliminim. Gjithashtu, është e papranueshme dhe në kundërshtim me parimet e prokurimit publik që në këtë fazë të procedurës AK të tentojë të krijojë apo interpretojë kritere shtesë që nuk kanë qenë të specifikuara qartë në Dosjen e Tenderit. Operatorët Ekonomik janë të obliguar të përmbushin

vetëm kriteret dhe kërkesat e publikuara paraprakisht në DT, ndërsa AK nuk mund të zgjerohet apo ndryshojë kuptimin e tyre pas dorëzimit të ofertave. Në rastin konkret, GOE ka vepruar plotësisht konform kërkesave të AK-së dhe ka dorëzuar të gjitha dëshmitë e kërkuara për Menaxherin e Projektit – Inxhinierin e Mjedisit, përfshirë edhe certifikatën nga AME. Rrjedhimisht, konsiderojmë se ky eliminim është arbitrar, i pambështetur në dokumentacionin real të ofertës dhe në kundërshtim me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë në procedurat e prokurimit publik.

Gjithashtu, sipas Nenit 40.12 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik:

“Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkesë apo kriteri që nuk është specifikuar në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.” 16/24 Pra, në vend të eliminimit, AK ka qenë i obliguar të kërkojë sqarim nëse ka pasur paqartësi, kjo bazuar në Nenin 53 dhe Nenin 72 të LPP-së. Kjo përbën shkelje të drejtpërdrejtë të Nenit 40.2 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, i cili përcakton se: “Autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kriteret ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.” Rrjedhimisht, ky kriter i aplikuar "ex post" është i paligjshëm dhe i pavlefshëm juridikisht.

9. ELEMENIM FORMAL LIDHUR ME PAJISJET

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues se kinse “nuk figuron asnjë kran për pastrimin e xhamave dhe asnjë makinë për pastrimin e rrugëve me specifikimet e kërkuara”, si dhe pretendimi se “automjetet e paraqitura nuk janë ekuivalente me ato të kërkuara në DT” është i pabazuar, i paarsyetuar në mënyrë konkrete dhe paraqet vetëm një eliminim formal pa mbështetje faktike dhe juridike. GOE ka dorëzuar të gjitha dëshmitë e kërkuara në Dosjen e Tenderit lidhur me pajisjet, mekanizimin dhe automjetet e nevojshme për realizimin e projektit, konform kërkesave të përcaktuara nga vetë Autoriteti Kontraktues. Kërkesa e Dosjes së Tenderit ka qenë si në vijim: “Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT. Kjo kërkesë vlen për dy lotet (1 dhe 2) sipas tabelave të bashkangjitura.” Po ashtu është kërkuar: “Një listë të pajisjeve sipas Aneksit 7, deklaratat unike doganore ose kontrata/fatura e blerjes për pajisjet që nuk regjistrohen dhe librezat e qarkullimit për automjetet që regjistrohen. Në rastet kur OE ka marrëveshje për shfrytëzim, OE duhet të dorëzojë edhe marrëveshjen për shfrytëzim.”

GOE ka përmbushur në tërësi këtë kërkesë duke: • paraqitur listën e pajisjeve sipas Aneksit 7; • bashkangjitur librezat e qarkullimit për automjetet; • bashkangjitur faturat, kontratat dhe deklaratat përkatëse; • si dhe marrëveshjet për shfrytëzim aty ku ka qenë e aplikueshme.

Për më tepër, janë dorëzuar të gjitha dëshmitë teknike dhe dokumentare që vërtetojnë posedimin dhe disponueshmërinë e pajisjeve të kërkuara, përfshirë edhe pajisjet për pastrimin e xhamave dhe automjetet/makineritë përkatëse.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues në arsyetimin e tij nuk ka specifikuar: • se cila pajisje konkrete mungon; • cili automjet konkret nuk i plotëson specifikat; • cilat specifika teknike nuk janë përmbushur; • apo mbi çfarë baze teknike dhe profesionale është konstatuar se pajisjet nuk qenkan “ekuivalente”.

Një konstatim i përgjithshëm dhe abstrakt, pa identifikuar konkretisht mangësinë apo mospërputhjen e pretenduar, nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për eliminimin e një Operatori Ekonomik. Në rastin konkret, AK nuk ka bërë asnjë analizë konkrete teknike mbi pajisjet e paraqitura nga GOE dhe nuk ka ofruar asnjë arsyetim profesional apo krahasim teknik që do të dëshmonte pretendimet e tij. Kjo tregon qartë se kemi të bëjmë me një eliminim formal dhe arbitrar, e jo me një vlerësim objektiv dhe të bazuar në prova. Po ashtu, pretendimi lidhur me

“mungesën e fotove të mjeteve” nuk mund të përdoret si bazë për eliminim nëse një kërkesë e tillë nuk është përcaktuar në mënyrë të qartë dhe eksplicite si kusht eliminues në Dosjen e Tenderit. GOE ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar sipas DT-së dhe nuk mund të penalizohet mbi baza të interpretimeve të mëvonshme apo kërkesave që nuk janë formuluar qartë paraprakisht.

Këtu Autoriteti Kontraktues ka përdorur standarde të dyfishta, pasi që operatorit të rekomanduar për kontratë për Lot-1, me datën 05.05.2026 përmes letrës standarde për sqarimin e ofertës i ka kërkuar plotësim dokumentacioni. Nëse Autoriteti Kontraktues ka menduar se janë të nevojshme fotot, përderisa i gjithë dokumentacioni i pajisjeve është i bashkangjitur, ka mundur që fotot ti kërkoj sipas Nenit 72 të LPP-së, pasi që fotot janë ekzistente. Rrjedhimisht, konsiderojmë se GOE ka përmbushur plotësisht kërkesat e Dosjes së Tenderit lidhur me pajisjet dhe mekanizimin, ndërsa arsyetimi i Autoritetit Kontraktues është i paqartë, i pambështetur në prova konkrete dhe në kundërshtim me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë në procedurat e prokurimit publik.

10. LIDHUR ME ELEMENINIMIN FOMRLA TË OFERTËS PËR KONTRATAT E REALIZUARA

Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues se kinse “shuma që ka prezantuar grupi i operatorëve ekonomik është 3,332,479.73 € dhe nuk e arrin shumën e kërkuar në Dosjen e Tenderit” është i pasaktë faktikisht, i pambështetur në një analizë konkrete dhe në kundërshtim me dokumentacionin e dorëzuar nga GOE në ofertë. GOE ka përmbushur plotësisht kërkesën e Dosjes së Tenderit, respektivisht kërkesën: “OE duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar kontrata për shërbime të ngjashme në tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë) minimumi 3,960,000.00 euro për Lot 1.”

Po ashtu, Dosja e Tenderit ka kërkuar: “Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të DT ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës t’i bashkangjiten kontratat, referencat apo certifikatat për kryerjen e punëve; kur shërbimet janë kryer për një blerës privat, për dëshmi të kryerjes së shërbimeve shërben dëshmia e pranimit të shërbimeve si dhe transaksionet bankare.”

GOE ka dorëzuar: • listat e kontratave për secilin pjesëtar të grupit; • referencat dhe kontratat përkatëse; • dëshmitë e realizimit të shërbimeve; • si dhe dokumentacionin mbështetës të kërkuar sipas DT-së.

Për më tepër, duke qenë se kemi të bëjmë me Grup të Operatorëve Ekonomik të përbërë nga gjashtë (6) anëtarë, përvoja profesionale dhe vlera e kontratave vlerësohet në mënyrë të kombinuar për të gjithë pjesëtarët e grupit, konform Nenit 71 të LPP-së dhe Nenit 26 të Rregullores Nr.001/2022. Në rastin konkret, GOE e ka përmbushur dhe madje tejkaluar vlerën minimale të kërkuar prej 3,960,000.00 euro, gjë që mund të verifikohet lehtësisht nga referencat, kontratat dhe dëshmitë e realizimit të shërbimeve të bashkangjitura në ofertë.

Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur: • asnjë tabelë konkrete të llogaritjes; • asnjë analizë se cilat kontrata nuk i ka marrë në konsideratë; • asnjë arsyetim se pse janë përjashtuar referenca të caktuara; • dhe asnjë sqarim lidhur me mënyrën se si ka arritur në shumën 3,332,479.73 €.

Një konstatim i tillë i përgjithshëm, pa analizë të detajuar dhe pa identifikim konkret të kontratave të refuzuara apo të mospranuara, nuk përmbush standardin minimal të arsyetimit administrativ dhe nuk mund të përdoret si bazë ligjore për eliminimin e Operatorit Ekonomik. Përkundrazi, dokumentacioni i dorëzuar nga GOE dëshmon qartë përmbushjen e kriterit të përvojës profesionale dhe vlerës së kontratave të kërkuara nga DT-ja. Rrjedhimisht, konsiderojmë se ky eliminim është bërë në mënyrë arbitrare, pa analizë objektive të dokumentacionit dhe në kundërshtim me parimet themelore të transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë në procedurat e prokurimit publik. Andaj, kërkojmë që kjo arsye për

eliminim të shpallet e pabazuar dhe oferta jonë të rivlerësohet në mënyrë të drejtë dhe të paanshme mbi bazën e dokumentacionit real të dorëzuar në ofertë.

11. LIDHUR ME ELEMENIMIN PËR PAJISJET AUTOMJETET TRAKTORËT ME LOPATA
Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues se kinse “Grupi i Operatorëve Ekonomik nuk ka arritur të dëshmojë me asnjë provë mjetet që janë kërkuar” është plotësisht i pabazuar, në kundërshtim me dokumentacionin e dorëzuar në ofertë dhe paraqet një vlerësim jo objektiv të dëshmimeve të paraqitura nga GOE. GOE ka dorëzuar listat e pajisjeve dhe mekanizimit konform Aneksit 7 të Dosjes së Tenderit, ku janë paraqitur në mënyrë të detajuar të gjitha pajisjet e kërkuara së bashku me specifikat dhe karakteristikat teknike përkatëse. Po ashtu, për secilën pajisje dhe automjet janë dorëzuar të gjitha dëshmitë e kërkuara nga Dosja e Tenderit, përfshirë: • librezat e qarkullimit; • marrëveshjet për shfrytëzim; • dokumentet pronësore; • faturat dhe dokumentacioni tjetër mbështetës; • si dhe dëshmitë që vërtetojnë disponueshmërinë reale të pajisjeve.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues në asnjë pjesë të arsyetimit nuk ka identifikuar konkretisht: • cilat pajisje nuk përputhen me kërkesat; • cilat karakteristika teknike mungojnë; • cilat mjete konkrete nuk i konsideron ekuivalente; • dhe mbi çfarë baze teknike është bërë një konstatim i tillë.

Një arsyetim i përgjithshëm dhe abstrakt, pa identifikim konkret të pajisjeve apo specifikave të pretenduara si të papërmbushura, nuk mund të shërbejë si bazë ligjore për eliminimin e një Operatori Ekonomik. Lidhur me pretendimin për “traktor me lopatë”, theksojmë se lopata nuk përbën mjet të veçantë motorik, por është aksesor apo pajisje shtesë që i bashkëngjitet traktorit sipas nevojës operative. Askund në botë në praktikën prodhuese dhe teknike nuk ekziston ndonjë prodhues që prodhon “traktor me lopatë” si kategori të veçantë të regjistrimit të automjetit. Traktorët regjistrohen si traktorë, ndërsa pajisjet shtesë si lopatat, plugjet apo aksesorët tjerë montohen dhe përdoren sipas nevojës. Rrjedhimisht, pretendimi i AK-së mbi këtë bazë është teknikisht dhe praktikisht i paqëndrueshëm, pasi librezat e qarkullimit natyrshëm identifikojnë mjetin bazë – respektivisht traktorin – dhe jo aksesorët e përkohshëm që i bashkëngjiten atij. Për më tepër, nëse Autoriteti Kontraktues ka pasur ndonjë paqartësi lidhur me ndonjë pajisje, aksesor apo karakteristikë teknike, ka pasur obligim që në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe administrimit të drejtë të kërkojë sqarime shtesë nga Operatorët Ekonomikë dhe jo të procedojë drejtpërdrejt me eliminim.

Në rastin konkret, AK nuk ka kërkuar asnjë sqarim shtesë dhe nuk ka bërë asnjë analizë konkrete teknike mbi pajisjet e paraqitura nga GOE, ndonëse të gjitha dëshmitë dhe specifikat janë dorëzuar në ofertë. 20/24 Rrjedhimisht, konsiderojmë se ky eliminim është bërë mbi baza të paqarta, të pambështetura në prova konkrete dhe në kundërshtim me parimet themelore të transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë në procedurat e prokurimit publik.

12. PAPËRGJEGJËSHMËRIA E OE TË REKOMANDUAR

Kompania jonë menjëherë pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK-së (B58) nga Autoriteti Kontraktues, ka paraqitur kërkesë për qasje në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit, si përmes platformës elektronike të e-Prokurimit, ashtu edhe përmes postës elektronike zyrtare (e-mail) me datën 07.05.2026, në përputhje me të drejtat e garantuara nga Ligji për Prokurimin Publik. Pavarësisht faktit se Autoriteti Kontraktues ka qenë plotësisht në dijeni për kërkesat tona, i njëjti nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të mundësuar qasjen e plotë në dokumentet e kërkuara, duke vepruar në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimet themelore të transparencës, trajtimit të barabartë dhe llogaridhënies, të përcaktuara me nenin 7 dhe nenin 10 të Ligjit për Prokurimin Publik. Mosveprimi i Autoritetit Kontraktues dhe lejimi i qasjes së kufizuar në këtë fazë të procedurës, qasja në ditën e fundit të parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim, sipas përgjigjes së AK-së ku e dërgon në email me datën 12.05.2026, krijojnë dyshime të bazuara lidhur me cenimin e integritetit dhe transparencës së procesit të prokurimit,

veçanërisht duke pasur parasysh refuzimin faktik për t'u mundësuar operatorëve ekonomik shqyrtimin e dokumentacionit të ofertës së operatorit të rekomanduar për kontratë. Në këto rrethana, kompania jonë ka dyshime serioze dhe të arsyeshme se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë për Lot-1 nuk i përmbushë kriteret dhe kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, ndërsa mungesa e qasjes në dokumentacion pamundëson verifikimin efektiv të ligjshmërisë së vendimmarrjes së Autoritetit Kontraktues.

Operatori i rekomanduar për kontratë nuk plotëson këto kërkesa:

- Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik –

* Gjatë qasjes në dokumentet publike, nuk na janë dhënë marrëveshjet e plota të lidhura ndërmjet operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë dhe ATK-së pasi që të njëjtat datojnë pas datës së publikimit të kontratës, ne kemi arritur ta shiqojmë fizikisht se të dy anëtarët e grupit, përkatësisht kompania Erik sh.p.k ka një marrëveshje të lidhur me datën 27.04.2026 të lidhur me 11 këste, dhe se njoftimi për kontratë është e datës 17.03.2026, që i bie se është pas njoftimit për kontratë, kurse kompania Schafberger Jr. GmbH ka një marrëveshje të lidhur me datën 27.03.2026 të lidhur poashtu me 11 këste, dhe ka tentuar lajthitur Autoritetin Kontraktues duke ia dhënë një marrëveshje të skaduar e cila ka qenë 12 muaj valide nga data e lidhur 27.12.2024, që mund të vërtetohet nga qasja e lejuar (shiqim), me këtë rast ky grup duhet të dërgohet për listë të zezë konform Nenit 99.2 të LPP-së, pasi që sipas deklaratave nën betim janë deklaruar se janë të përshtatshëm, ku edhe do ti njoftojmë organet ligjëvendëse, nëse AK nuk ndërmerr asnjë veprim në lidhje me këto dëshmi.

Poashtu sipas Interpretimit të publikuar nga KRPP me numër 6 të datës 22.11.2022 thuhet: A duhet OE me rastin e dorëzimit të ofertës të dëshmojnë se nuk janë në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së?

[...]Në përputhje me paragrafin 5 të nenit 65, periudha kohore, se në cilën periudhë duhet të jetë OE i “pranueshëm”, ndërlidhet me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të thotë se OE duhet të jetë i “pranueshëm” në datën e publikimit të njoftimit. Borxhet mund të lindin në periudha të ndryshme p.sh. gjatë procesit të vlerësimit, gjatë fazës së ankimimit, prandaj ky nen përcakton kohen kur OE duhet të jetë i pranueshëm. Nisur nga fakti se shumë OE kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-në, KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës. Qëllimi i këtij neni është që OE duhet të jetë gjithmonë “i pranueshëm”, pra OE nuk duhet të ketë obligime të pashlyera në kohen e publikimit të Njoftimit për kontratë.” Andaj ky grup i operatorëve ekonomik është i papërgjegjshëm dhe duhet të eliminohet, për shkak se vërtetimet me obligime (kanë borxhe tatimore), dhe se marrëveshjet i kanë pas datës së njoftimit për kontratë.

Shtojcë: Komunikimet me ATK (dokument)

Kapaciteti teknik dhe ose profesional -

* I njëjti pretendojmë se tek Lista e Çmimeve - çmimet për materialin higjienik i ka me çmime shumë të ulta të cilat nuk janë çmime reale të tregut dhe janë të nënvlerësuar, ku AK tek Lista e Çmimeve u ka dhënë sqarim njoftues, gjë që nuk do të mundëson të bëjë furnizimin adekuat të objekteve. * I njëjti pretendojmë se nuk posedon MSDS të materialeve përkatësisht etiketat e produkteve konform kërkesës së AK-së, mungojnë MSDS të produkteve higjienike. * I njëjti pretendojmë se nuk e ka menaxherin e riskut me dokumentacion të plotë, mungojnë dëshmit përkatëse si: certifikata e ISO 31000 nuk është konform standardeve dhe e pavlefshme, kompania që ka lëshuar këtë certifikatë sipas burimeve zyrtare në internet nuk ka asnjë program të till të akredituar. Certifikata e lëshuar me numër MLK XK-RM-10102022 është verifikuar në faqen zyrtare të kompanisë e cila ka lëshuar certifikatën MLK International Certification and Education Services <https://mlkgrup.com/trainingen.asp> E njëjta pas verifikimit rezulton

“Cancelled” që nënkupton e “Anuluar”. Kurse certifikata e lëshuar me numër MLK-XK-RM-10102025 është verifikuar në faqen zyrtare të kompanisë e cila ka lëshuar certifikatën MLK International Certification and Education Services <https://mlkgrup.com/trainingen.asp>. E njëjta pas verifikimit rezulton “Valid” e cila tregon se certifikata është lëshuar me datën 10.10.2025, e që tregon se kërkesa përvoj pune min.3 vite pas certifikimit nuk plotëson kërkesën e Autoritetit Kontraktues. * I njëjti pretendojmë se nuk e ka në rregull Analizën financiare duke munguar elementet përkatëse të ligjit të punës, kërkesë e përmendur nga AK në Dosjen e tenderit. 22/24 * I njëjti pretendojmë se pajisjet e listuara në Aneksin 7 të dosjes së tenderit, nuk ka bashkangjitur dokumentacionin e plotë të pajisjeve, duke munguar dëshmitë ku tregojnë specifikimet e qarta të këtyre pajisjeve; shembull: Krani për pastrimin e xhamave, i njëjti ka bashkangjitur një librezë të pajisjes me emërtim “kamionë me korpë”, ku nuk mund të konstatohet se pajisja e bashkangjitur është me lartësi 5 kate siç është kërkuar; poashtu supozojmë se pajisjet e listuara me numër rendor 7,8,9,12 poashtu nuk janë sipas kërkesave të AK-së pasi që mungon dokumentacioni i plotë ku mund të shihen specifikat dhe karakteristikat e pajisjeve që janë konform kërkesave të AK-së. * I njëjti pretendojmë se specifikat e pajisjeve sipas numrave rendor të lartëcekur nuk kanë të dhënat specifike si: 900-1000cm³, 1000-1150cm³, 5 kate lartësi, 11kw, në dëshmitë e dorëzuara. * I njëjti pretendojmë se nuk ka të bashkangjitura pagesat e faturave të bashkangjitura për pajisjet, nuk posedojnë transaksionet bankare të kryera.

* Poashtu pas verifikimit të një marrëveshjeje të cilën e ka të ngarkuar me ofertë të lidhur ndërmjet kompanisë “Schafberher Jr GmbH – Dega në Kosovë dhe kompanisë Danfos” ka rezultuar se e njëjta marrëveshje nuk ka qenë e lidhur për “këtë” aktivitet të prokurimit dhe se pajisjet në fjalë nuk ia ka dhënë në dispozicion kësaj kompanie për të aplikuar në këtë tender.

Shtojcë: Komunikimet zyrtare me e-mail me kompaninë Danfos të datës 13.05.2026.

Gjithashtu, sipas Nenit 7.6.3 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik:

“Zyrtari i Prokurimit sipas kërkesës për qasje në dokumente nga OE (siç përkufizohet në nenin 4, paragrafi 1, nën paragrafi 1.26 të LPP-së), pas publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK (B58), ofron qasjen e menjëhershme në versionin e pastruar dhe mban procesverbal, i cili nënshkruhet nga të dyja palët.” Me çrast Autoriteti Kontraktues, qasjen është dashur ta lejoj ashtu siç thuhet në dispozitën e lartëcekur, menjëherë, e jo të mos e lejoj për palët e interesit. Në mungesë të qasjes në dokumentet publike, ne nuk kemi arritur të analizojmë dokumentacionin e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, andaj ky veprim i AK-së është i qëllimshëm dhe në mënyrë të drejtëpërdrejtë dëmton kompaninë tonë dhe në anën tjetër favorizon operatorin ekonomik fitues sipas AK-së. AK poashtu ka vepruar në kundërshtim me Nenin 72 të LPP-së, pasi që për Lot-1, operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë i ka kërkuar sqarime shtesë, kurse për mangësitë që ka supozuar në dokumentacionin tonë nuk ka bërë asnjë kërkesë, me çrast ka përdorur standarde të dyfishta, sepse të dy ofertuesit para AK-së është dashur të trajtoheni njëjtë në mënyrë të barabartë

13. KONKLUZION Nga sa më sipër rezulton qartë se: - të gjitha arsyet e eliminimit janë formale, të paqëndrueshme dhe të pabazuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, - janë aplikuar kërkesa të reja pas dorëzimit të ofertave, në kundërshtim me LPP dhe Rregulloren 001/2022 për Prokurimin Publik me qëllim të eliminimit të kompanisë sonë, - është shkelur parimi i barazisë, transparencës, trajtimit jo të barabartë (neni 7 i LPP së) dhe mos-përdorimit ekonomik të fondeve publike (neni 1 dhe 6 i LPP-së). Poashtu vlen të ceket dispozita ligjore e Nenit 40.15 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik: “40.15 Gjatë kohës së vlerësimit të tenderit, informacione në lidhje me shqyrtimin, sqarimin, vlerësimin, krahasimin e tenderëve, pikat e dhënë, dhe rekomandimi për dhënie, nuk do t’ju zbulohet ofertuesve apo ndonjë personi tjetër që nuk janë të përfshirë zyrtarisht në ekzaminimin, vlerësimin e tenderëve deri sa të jete publikuar Formulari B58 Njoftimi mbi Vendimin e AK.”

14. KËRKESË Kërkojmë që Organi Shqyrtues i Prokurimit: 1. Të aprovojë këtë ankesë si të bazuar në ligj; 2. Të anulojë vendimin mbi njoftimin e AK-së; 3. Të kthej procedurën në Rivlerësim; 4. Të sigurojë zbatim të drejtë dhe të njëtrajtshëm të LPP-së dhe rregullores për prokurim publik. 5. Të vlerësoj ofertat konform Nenit 59.4 të LPP-së, në vend të eliminimit të qëllimshëm për favorizim të operatorit të caktuar

Në të kundërtën, do të detyrohem të vazhdojmë me ankesë pranë Gjykatës kompetente për mbrojtjen e konkurrencës së barabartë, dhe trajtimin e lëndës konform dosjes së tenderit.

Lidhur me pretendimet e OE “International Security AAH” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0330 kanë vlerësuar si në vijim:

Pergjigje ne Pretendimin Ankimor 1.Gjate analizes se DT te ngarkuar nga OE ankues verej se ne folderin 12.1 ka te ngarkuar menaxherin sipas kerkeses se DT-së mirpo nuk e ka te shenuar ne analizen financiare dhe mendoj se ky pretendim është **pjeserisht i bazuar.**

Pergjigje ne Pretendimin Ankimor 2.OE ankues ne folderin 11 ka ngarkuar analizen financiare por gjate analizes verehet se nuk e ka futur menaxherin e riskut me page bruto 600 euro me cka mendoj se kish pas ndryshime ne cmimin total te ofertes financiare te kalkuluar nga OE dhe ky pretendim ankimor është **pjeserisht i bazuar.**

Pergjigje ne Pretendimin Ankimor 3.Sa i perket pretendimit ankimor per formatin exell mendoj se OE ka pretendimin ankimor **te bazuar** sipas LPP-së dhe Rregullores për Prokurimin Publik:

Pergjigje ne Pretendimin Ankimor 4.Eksperti shqyrtues gjat analizes se DT te kerkuar nga AK vren qart se ne Aneksin 7 Lista e paisjeve per Lot II ne kolonen D jane kerkuar te dhenat e paisjeve **(viti I prodhimit ,gjendja e pajisjes , kamiona rexe. I targave, mekanizimi , dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim ,foto etj** ndersa ne shiqimin e DT te ngarkuar nga OE ankues nuk gjenden fotot siq është kerkuar dhe mendoj se pretendimi ankimor është **i pabazuar**

Pergjigje ne Pretendimin Ankimor 5.Gjate analizes dhe shiqimit te ofertes se GOE te rekomanduar per kontrat vrehet qarte se ne folderin 15 te shenuar si dok per menaxherin dhe pergjegjsin ka te ngarkuar menaxherin z.Skender Krasniqi me page 700 euro bruto sipas kerkseva te DT-së te kerkuar dhe mendoj se ky pretendim është **pabazuar**

Pergjigje ne Pretendimin Ankimor 6.Ne oferten e GOE te rekomanduar per kontratë ne folderat 11.13.14 i ka te ngarkuara MSDS te produkteve dhe materialeve sipas kerkese se DT dhe ky pretendim ankimor është **i pabazuar.**

Pergjigje ne Pretendimin Ankimor 7.Gjate analizes se ofertes se GOE te rekomanduar per kontrate gjendet i ngarkuar menaxheri i riskut znj.Gentiana Krasniqi si dhe ka te ngarkuar certifikaten ISO 31000:2018 - Enterprise Risk Management Framework for Risk Leaders te leshuar ne janar 2026 mirpo mendoj se nuk perben ndonje element per mos plotesim te kerkeses se DT te kerkuar nga AK po ashtu mendoj se ky pretendim ankimor është **pjeserisht i bazuar**

Pergjigje ne Pretendimin Ankimor 8.Eksperti shqyrtues gjatë analizes se ofertes te ngarkuar nga GOE te rekomanduar per kontratë konstaton se ne folderin e ngarkuar me nr 23 është e perpiluar analiza financiare me te gjitha elementet siq është kerkuar ne DT si dhe GOE po ashtu ka bere analizen edhe te zevendesimit te puntorve pushimin vjetor me te gjitha elementet me qka mendoj se pretendimi ankimor është **i pabazuar**

Pergjigje ne Pretendimin Ankimor 9.Sa i perket pretendimit ankimor ne lidhje me certifikatat Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë te ngarkuara nga GOE i rekomanduar per kontrat

eksperti shqyrtues ne konsultim me ligjin NR.04/L-161 konstaton se ne as nje nen te ketij ligji nuk ceket se certifikatat kanë vlefshmeri dy (2) vjeqare,duke u bazuar ne ligj dhe ne dukumentacion te ofertes mendoj se ky pretendim ankimor **është i pabazuar**.

Pergjigje ne Pretendimin Ankimor 10.

Pas analizes se dukumentacionit te ngarkuar nga GOE i rekomanduar per kontrat konstatohet se ne oferten e ngarkuar gjenden pasijet e ankimuar nga OE ankues te gjitha paisjet jane te shenuar ne folderat 6,7, 7.1 konstatohet se pretendimi ankimor **është i pabazuar** dhe sa i perket ketij pretendimi mendoj se GOE i rekomanduar per kontrat ploteson kerkesat e DT-së te kerkuar nga AK.

Lidhur me pretendimet e OE “Farilo” SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0331 kanë vlerësuar si në vijim:

Pergjigjja ne pretendimin ankimor 1.Eksperti shqyrtues gjate analizes se DT te ngarkuar nga OE vrehet qarte se OE ankues deklaratat e koncerciumit i ka te nenshkruara dhe te vulosura ne menyre te rregullt mirpo ne procesverbalin e hapjes se tenderit vrehet se vetem OE Ferilo është i shenuar ndersa OE ne koncercium i kan vetem inicialet dhe duke i analizuar dukumentet e ngarkuara eksperti mendon se pretendimi ankimor **është pjeserisht i bazuar**.

Pergjigjja ne pretendimin ankimor 2.Gjate analizes se dukumentacionit te ngarkuar si dhe te gjitha shkresave te lendes vrehet se OE ankues ka ne DT analizen financiare mirpo duke analizua dukumentin e ngarkuar vrehet se ne analizen e ngarkuar nuk e ka te llogaritur materialin hixhenik si dhe pagat e manxherve te kontrates siq eshte kerkuar ne DT.ne baze te projektit i cili ka te bej me institucione arsimore mendoj se analiza kish qen dast te llogaritet me 22 dit dhe 176 ore,mendoj se ky pretendim ankimor **është i pabazuar**.

Pergjigjja ne pretendimin ankimor 3.Sa i perket pretendimit ankimor per formatin exell mendoj se OE ka pretendimin ankimor **te bazuar** sipas LPP-së dhe Rregullores për Prokurimin Publik:

Pergjigjja ne pretendimin ankimor 4.Eksperti shqyrtues gjat analizes se DT te kerkuar nga AK vren qart se ne Aneksin 7 Lista e paisjeve per Lot1 ne kolonen D jane kerkuar te dhenat e paisjeve (viti I prodhimit ,gjendja e pajisjes , kamiona rexe. I targave, mekanizimi , dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim ,foto etj ndersa ne shiqimin e DT te ngarkuar nga OE ankues nuk gjenden fotot siq është kerkuar dhe mendoj se pretendimi ankimor **është i pabazuar**

Pergjigjja ne pretendimin ankimor 5.Sa i perket menxherit me page 600 euro e cila eshte kerkuar ne DT Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 ne dosje te ngarkuar nga OE ankues tek folderi 12.1 Menaxheret ka te ngarkuar z.Qamil Zenelaj i cili ka kontrat me antarin e koncerciumit Internacional Group Base sh.p.k me qka mendoj se pretendimi ankimor **është i bazuar**.

Pergjigjja ne pretendimin ankimor 6.Lidhur me eliminimin nga ana e AK per GOE ankues mendoj se ne kerkesat e DT-së ka qene e specifikuar perfshirja e menaxherve ne analizen financiare tek kerksat Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 **OE duhet te kete nje menagjer te projektit me vendim i cili duhet të jetë Inxhinier i Mjedisit, i Certifikuar si Ekspert i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë nga MPMS MFPT, gjithashtu i certifikuar për vlerësimin e rreziqeve nga AME, si dhe për zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera. me page prej 700.00 €, OE duhet te kete nje person te diplomuar me beachelor dhe te certifikuar sipas standarteve ndërkombetare për menaxhimin e riskut (rrezikut) me certifikatë i cili ka përvoj pune min.3 vite pas certifikimit me page prej 600.00 € Vlen për lot 1. OE duhet të ketë një menaxher me**

përvojë pune së paku 7 vite me pagë prej 700 euro Bruto, te perfshihet ne analizen financiare dhe te deshmohet me trust dhe kontratë të punës. OE ne analizen financiare te ngarkuar nuk ka te perfshir menaxheret siq është kerkuar dhe mendoj se pretendimi ankimor është i pabazuar

Pergjigjja ne pretendimin ankimor 7.Gjate analizes dhe shiqimit te DT kam vrejtur se AK ne DT ka kerkuar ne menyre specifike konkretisht ne piken 9.1.Kapaciteti teknik dhe professional:Kapaciteti teknik dhe professional:OE duhet të ofroj dëshmi të mjaftueshme se ka realizuar kontrata për shërbime te ngjashme ne tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te njoftimit për kontrate) minimumi 3,960.000.00 euro për lot. *Dëshmia e kërkuar dokumentare* **Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar aneksin 6 të DT ku duhet saktësuar titullin e kontrates, shumen e kontrates, daten e fillimit dhe daten e perfundimit dhe perfituesin, si dhe listes ti bashkangjiten kontratat, referencat apo certifikatat per kryerjen e puneve, kur sherbimet jane kryer per nje bleres privat, per dëshmi te kryerjes se sherbimeve shërben dëshmi e pranimi te sherbimeve si dhe transaksionet bankare.** GOE ankues ka te ngarkuar nje list te kontratave dhe referencave per disa kontrata ndersa njeri antar i koncerciumit ka te ngarkuara vetem referenca mirpo gjat analizes kam vrejtur se GOE nuk ka mundur te deshmoj se ka arritur vleren e kerkuar ne tri vitet e fundit siq është kerkuar ne DT me qka mendoj se pretendimi ankimor është i pabazuar

Pergjigjja ne pretendimin ankimor 8. Ky pretendim ankimor është i bazuar pasi qe ne DT te ngarkuar nga GOE ankues ne folderin 12.1 gjendeet ing z.Vehbi Goxhuli.

Pergjigjja ne pretendimin ankimor 9. Sa i perket listes se paisjeve GOE ka te ngarkuar nje list te paisjeve me libreza dhe duda si dhe fatura mirpo nuk ka deshmuara me foto siq është specifikuar ne DT ne aneksin 7 kolona D dhe besoj se ky pretenim u sqaru dhe me lart tek pretendimi nr 4 dhe sa i perket librezave dudave dhe faturave ky pretendim është pjesrisht bazuar.

Pergjigjja ne pretendimin ankimor 10. Ky pretenim ankimo është trajtuar dhe me lart ne pergjigjen e pretenimit ankimor nr 7 dhe po ashtu është i pabazuar

Pergjigjja ne pretendimin ankimor 11. Ky pretendim ankimor është i bazuar p[asi qe ne dosjen e ngarkuar ne folderin 10 ka tengarkuar marrvehjen anatori i koncerciumit ELRON SH.P.K me XHEMSIR SADRIAJ BI per traktorin te tipit ISEK dhe ky pretendim mendoj qe është i bazuar

Pergjigjja ne pretendimin ankimor 12.Sa i perket pretendimit ankimor per OE fitues ne lidhje me certifikatat e ATKS-së mendoj se është ne pergjegsin e zyrtarit te prokurimit dhe nuk do te lshohem ne kete pretendim.

Poashtu sa i perket materialit hixhenik gjate hulumtimit te tregut kam vrejtur se jane ne perputhmeri me cmim te tregut si dhe ne dosjen e ngarkuar nga OE i shperbyer me kontrat gjenden te gjitha MSDS të materialeve përkatësisht etiketat e produkteve konform kërkesës së AK-së, .

Certifikatat e ISO tash jane online dhe mund te vertetohen ose vazhdohen online qe nuk ka ndonje shkele apo penges tek keto certifikata po ashtu ka te ngarkuara te gjitha paisjet sipas specifikacionit teknik .me qka mendo se pretendimi ankimor është i pabazuar.

-Seanca shqyrtuese-

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në

aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit.

Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e OE ankues; “International Security AAH” SH.P.K. & “Farilo” SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorëve ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimet ankimore të OE ankues janë të paqëndrueshme ashtu siç janë dhënë në konstatimin e panelit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 1 dhe 4 të LPP-së, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES, KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - International Security AAH SH.P.K., FARILO SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: